

**GARA NDËRKOMBËTARE NGA MATEMATIKA
KENGUR**

21 MARS 2006

PËR KLASËN E 5 DHE 6 TË SHKOLLAVE FILLORE

Testi punohet me kohëzgjatje prej 1 orë e 15 minuta


Për përgjigje jo të saktë të pyetjes ju hiqen një e katërta e pikëve me të cilët pyetja vlerësohet. Që të shmangët rezultati final negativ në fund shtohen 30 pikë, ashtu që numri i mundëshëm i pikëve të fituara është 150. Nuk lejohet përdorimi i kalkulatorëve.

Secila prej detyrave me numër rendorë prej 1 deri 10 vlerësohet me 3 pikë

1. Nëse $3 \times 2006 = 2005 + 2007 + a$, atëherë a është e barabartë me:

- A) 2005 B) 2006 C) 2007 D) 2008 E) 2009

2. Gjashtë numra janë shënuar në gjashtë kartuçe si në vizatim. Cili është numri më i madh që mund të formohet me ndihmën e kartuçeve ?



- A) 9 876 543 210 B) 4 130 975 682
C) 3 097 568 241 D) 7 568 413 092
E) 7 685 413 092

3. Katër nxënës mund të ulen në një tavolinë në formë të katrorit, secili në një anë të tavolinës. Për një festim shkollorë nxënësit kan bashkuar 10 tavolina të tilla që të përfitojnë një tavolinë më të madhe. Sa nxënës mund të ulen në atë tavolinë ?

- A) 20 B) 22 C) 30 D) 32 E) 40


4. Nëse



= 500 denarë



dhe



= 1200 denarë,

atëherë sa koshton një top ?

- A) 100 B) 200 C) 300 D) 400 E) 500

5. Zgjedhe figurën në të cilën këndi midis akrepave të orës është 150° .

A)



B)



C)



D)



E)



6. Në anën e djathtë të një rruge numrat rendorë të shtëpive janë numrat tek prej 1 deri më 39. Në anën e djathtë të gjitha shtëpitë kanë numra çift prej 2 deri më 34. Sa shtëpi numëron rruga ?


- A) 8 B) 36 C) 37 D) 38 E) 73

7. Në sa mënyra mund të fitohet numri 2006 duke bërë lëvizje vetëm sipas shigjetave ?



- A) 12 B) 11 C) 10 D) 8 E) 6

8. Gjysma prej të njëqindëtës pjesë është:

- A) 0,005 B) 0,002 C) 0,05 D) 0,02 E) 0,5




9. Trupit në figurë i përgjigjet rrjeta :



E) asnjëra

10. Me 9 kg ngjyrë mundemi të ngjyrosim një kub të tërë. Me sa kg ngjyrë do të ngjyrosim vetëm pjesën e bardhë ?



A) 2

B) 3

C) 4.5

D) 6

E) 7

Secila prej detyrave me numër rendorë prej 11 deri 20 vlerësohet me 4 pikë

11. Sa është perimetri i yllit nëse dihet se ai është formuar prej 4 rrrathëve të barabartë me rreze 5 cm, një katrori dhe prej 4 trekëndëshave barabrinjas ?



A) 40 cm B) 80 cm C) 120 cm D) 160 cm E) 240 cm

12. Sa është ndryshimi ndërmjet shumës së 1000 numrave çift natyrorë dhe shumës së 1000 numrave tek natyrorë ?

A) 1 B) 200 C) 500 D) 1000 E) 2000


13. Një letër ka formën e gjashtëkëndëshit të rregullt si në figurë. Çfarë figure të fitoheshin nëse kulmet e shënura priten në qendrën e gjashtëkëndëshit ?

A) yll gjashtëkëndorë B) dymbëdhjetëkëndësh
C) gjashtëkëndësh
D) katrorë E) trekëndësh



14. Një katrorë është ndarë në 10x10 katrorëz të vegjël. Katrorëzët në diagonalet janë ngjyrosur me: të kuqe (k), të bardhë (b), të kaltërt (kt), të gjelbërt (g), portokalli (p), të kuqe (ke), të bardhë (b), të kaltërt (kt)...Me cilën ngjyrë do të ngjyroset katrorëzi në këndin ?

A) të kuqe (k) B) të bardhë (b)
C) të kaltërt (kt) D) të gjelbërt (g) E) portokalli (p)



15. Nëse $\overline{AB} = 4\text{cm}$, $\overline{BC} = 1\text{cm}$, pika E është mesi i \overline{AB} , F mesi i \overline{AE} , G mesi i \overline{AD} dhe H mesi i \overline{AG} , atëherë syprina e drejtkëndëshit të hijezuar është :

- A) $1/4 \text{ cm}^2$ B) 1 cm^2 C) $1/8 \text{ cm}^2$
 D) $1/2 \text{ cm}^2$ E) $1/16 \text{ cm}^2$




16.
$$\begin{array}{r} 1111111111 \\ - 1111111111 \\ + 1111111111 \\ - 11111111 \\ + 1111111 \\ - 111111 \\ + 11111 \\ - 1111 \\ + 1111 \\ - 111 \\ + 11 \\ - 1 \\ \hline \end{array}$$
 ?
- A) 1111111111 B) 1010101010
 C) 1000000000 D) 9999999999
 E) 0

17. Sa kube të ndryshëm ekzistojnë me 3 brinjë të kaltërta dhe me 3 të kuqe ?


- A) 1 B) 2 C) 3 D) 4 E) 5

18. Diametri i rrethit është $\overline{AB} = 10\text{cm}$. Sa është perimetri i figurës së hijezuar në vizatim, nëse të gjitha drejtkëndëshat janë të puthitshëm ?

- A) 8 cm B) 16 cm C) 20 cm D) 25 cm E) 30 cm



19. Gjashtë automjete janë të parkuar në një parking. Njëri don që të zhvendoset prej vendit S deri te F duke kaluar rrugë sa më të shkurtër. Cila është ajo rrugë ?



- A) B) C) D) E) të gjitha rrugët janë të njejta

20. Në segmentin OE me gjatësi 2006 njësi të barten pikat A, B, C a.q $\overline{OA} = \overline{BE} = 1111$ njësi dhe gjatësia e segmentit OC është e barabartë me 70 % të gjatësisë së segmentit OE. Sipas cilës renditje duhet të barten pikat prej O deri te E?

- A) OABCE B) OACBE C) OCBAE D) OBCAE E) OBACE


Secila prej detyrave me numër rendorë prej 21 deri 30 vlerësohet me 5 pikë

21. Paleta me gjatësi 15dm është ndarë në pjesë me numër më të madh të mundshëm me gjatësi të ndryshme nga bashkësia e numrave të plotë në dm. Numri i ndarjeve është:

- A) 3 B) 4 C) 5 D) 6 E) 15.

22. Lumi kalon nëpër një qytet dhe formon 2 ishuj. Mbi lum kemi 6 ura (si në vizatim). Sa rrugica kemi që fillojnë nga pika A e bregut deri në pikën B, a.q nëpër secilën urë të kalohet vetëm një herë ?

A) 0 B) 2 C) 4 D) 6 E) më shumë se 6




23. Cilët nga numrat e dhënë kanë ndryshim të njejtë midis veti nëse barten në bosht numerik ?

A) $1/3, 1/4, 1/5$ B) 12, 21, 32 C) 0.3, 0.7, 1.3
D) $1/10, 17/160, 9/80$ E) 24, 48, 64

24. Ana ka llogaritur shumën prej numrit më të madh dhe më të vogël dyshifrorë që plotëpjestohen me 3. Burimi e ka llogaritur shumën e numrit më të madh dhe më të vogël dyshifrorë që nuk janë të plotëpjestueshëm e 3. Për sa numri i Anës është më i madh se i Blerimit ?

A) 2 B) 3 C) 4 D) 5 E) 6

25. Blerta ndërton katrorë me shkorkat e qibrutit në mënyrë që u shton katrorëve paraprak si në vizatimin e dhënë. Sa shkorka duhet të shtojë në katrorin e tridhjetë që të përfitojë të 31 katrorë ?



A) 124 B) 148 C) 61 D) 254 E) 120

26. Numrat natyrorë prej 1 deri më 2006 janë shënuar në tabelë. Petriti i ka nënvizuar të gjitha numrat të plotëpjestueshëm me 2, pastaj të gjithë ato të plotëpjestueshëm me 3 dhe në fund të gjithë që plotëpjestohen me 4. Sa numra janë nënvizuar saktësisht dy herë ?

A) 1003 B) 1002 C) 501 D) 334 E) 167


27. Cili është numri më i vogël i pikave që duhet të fshihen nga shema e dhënë ashtu që asnjë treshe prej pikave të mbetura nuk janë brinjë të një trekëndëshi barabrinjas ?



A) 2 B) 3 C) 4 D) 5 E) 6

28. Dy shokë Aleksandri dhe Bojani kanë ndezur zjarr duke i shfrytëzuar 15- të copa të barabarta druri. Prej tyre, aleksandri ka sjellë 8 kurse Bojani 7 . Jovani don që të shfrytëzojë zjarrin e tyre dhe më pastaj tu paguaj për shërbimin e bërë. Jovani ka 30 mënetat me vlerë të njejtë. Mënyra e saktë për ndarjen e atyre monetave është:


A) 22 për Aleksandrin dhe 8 për Bojanin B) 20 për Aleksandrin 10 për Bojanin
C) 15 për Aleksandrin 15 për Bojanin D) 16 për Aleksandrin 14 për Bojanin E) 18 për Aleksandrin 12 për Bojanin




29. Në faqet e kubit janë shënuar disa shkronja. Vizatimi 1 paraqet një shemë për kubin e përshkruar. Cila shkronjë duhet të qëndrojë në vendin e pikëpyetjes në shemën tjetër të kubit (viz. 2)?

A) A B) B C) C D) E

E) nuk mund të jepet përgjigje



30. Në sa mënyra mund të shënohen numrat 1,2,3,4,5,6 në katrorë si në fig. duke shënuar secilin numër në një katrorë a.q nuk ekzistojnë katrorë fqinjë që ndryshimi i numrave të shënuar në to të jetë 3? (Katrorët që kanë një kulm të përbashkët nuk janë fqinjë)



A) 3×2^5 B) 3^6 C) 6^3 D) 2×3^5 E) 3×5^2